

**SHOQERIA "SPAR ALBANIA" SH.P.K.**  
**Farke ,Lunder, Qendra Tregtare Tirana East Gate,**  
**Rruga Nacionale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder, Tirane,**

**TIRANE-ALBANIA**

### **MARREVESHJE BASHKIMI**

Sot me date 20.11.2018 (Dymijetetembedhjet), ne seline e shoqerise "**Spar Albania**"sh.p.k.. u perpilua Marreveshja e Bashkimit me perthithje, ne referim te plote me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008"Per Tregtare e Shoqerite Tregtare" Nenet 215-225, nga shoqerite si me poshte:

Shoqeria "**Spar Albania**"sh.p.k.,Person juridik I te drejtes Shqiptare me seli ne Farke ,Lunder, Qendra Tregtare Tirana East Gate,Rruga Nacionale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder, Tirane, me NIPT L51603008A, qe perfaqesohet nga administratori I saj perfaqesuesi ligjor Znj.Elona Mema, shtetase shqiptare, lindur ne Patos-Fier, me date 07.12.1981, banues ne Tirane, mbajtes e leternjofimit nr.03023591, dhe nr.personal I16207127A madhore me aftesi te plote ligjore per te vepruar.

Me poshte e quajtur Shoqeria **PERTHITHESE**

Dhe

Shoqeria"**Spar Elbasan**"Sh.p.k., Person juridik I te drejtes Shqiptare me adrese ne Lagjja Çlirimi, Rruga Thoma Kalefi, Zona Kadastrale 8522, Godina ish "Kinoklubi" me nr. pasurie 8/67-2/2 Elbasan, me NIPT L72622203C, qe perfaqesohet nga administratori I saj perfaqesuesi ligjor Z.Elton Serjani, shtetas shqiptar , lindur ne, me Tirane date 18.10.1976, banues ne Tirane, mbajtes I leternjofimit nr 027999179 madhor me aftesi te plote ligjore per te vepruar.

Me poshte e quajtur Shoqeria qe **PERTHITHET**

Duke patur parasysh dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtare e Shoqerite Tregtare" Neni 216 pika 2 hartojne si me poshte:

**MARREVESHJE E BASHKIMIT** te shoqerive tregtare te permendura me siper.

Palet bien dakort te lidhin kete marreveshje me kushtet e meposhtme:

#### **1- DRJETIMI I BASHKIMIT**

Ne kete operacion bashkimi te shoqerive tona tregtare nepermjet perthithjes, referuar neneve 215-225 Shoqeria "**Spar Albania**"Sh.p.k., me NIPT L51603008A, do te jete Shoqeria Perthithese e cituar ne vijim si **Shoqeria Perfituese**, kurse Shoqeria "**Spar**

Elbasani”Sh.p.k., me NIPT L72622203C do te jete shoqeria e perthithur ne vijim si shoqeri Kontribuese.

## 2- MOTIVET DHE QELLIMET E BASHKIMIT

Grupimi i Eksperienave, Njohurive, Performances, Kualifikimeve, Licencave, Mjeteve, per rritjen e perfitimeve e rentabilitetit ne shoqerine Perthithese si dhe pasurimin e CV-se te saj per ofrimin e sherbimeve e tregetin e produkteve e mallrave te ndryshem. Ulje e kostove te menaxhimit, si dhe sigurimin e nje fitimi me optimal te ortakut.

## 3-AKTIVET dhe PASIVET(DETYRIMET) PARASHIKUARA PER TU TRANSFERUAR.

Ne zbatim te ketij operacioni Bashkimi nepermjet perthithjes parashikohet qe shoqeria kontribuese “Spar Elbasani”Sh.p.k. ti transferoje (kaloj) Shoqerise “Spar Albania”Sh.p.k., teresisht elementet e Aktivit dhe Pasivit te saj, referuar bilancin e saj ne Pasqyrat Financiare te hartura me daten 31.08.2018 duke perfshire edhe te gjitha transakcionet e realizuara pas kesaj date deri ne Miratimin Perfundimtar te kesaj Marreveshje Bashkimi.

Grupet Kryesore te Aktiveve dhe Pasiveve te Shoqerise Kontribuese “Spar Elbasani” jane caktuar, vleresuar dhe pranuar sipas Pasqyrave Financiare te dates 31.08.2018 dhe qe deklarohen prane organeve tatimore dhe QKB, si me poshte:

<b>AKTIVE</b>	
<b>Aktivet Afatshkurtera</b>	<b>99,114,197</b>
<i>Aktive Monetare</i>	19,356,281
Të drejta të arkëtueshme	34,682,832
Inventarët	45,075,085
<b>Shpenzime të shtyra</b>	<b>-</b>
<b>Aktivet Afatgjata</b>	<b>19,772,536</b>
Aktive Afatgjata Materiale(AAM)	19,772,536
<b>Aktivet te Tjera</b>	<b>-</b>
<b>Totali I Aktiveve</b>	<b>118,886,733</b>
<b>PASIVE</b>	
<b>Detyrimet Afatshkurtera</b>	<b>92,249,026</b>
Detyrime ndaj punonjesve	
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	1,050,689

<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore</i>	90,890,132
<i>Te pagueshme per detyrimet ndaj ortakeve</i>	308,205
<b>Detyrime Afatgjata</b>	-
Detyrime ndaj institucioneve te kredise	-
<b>KAPITALI</b>	
<b>Kapitali I nenshkruar</b>	<b>33,765,000</b>
<i>Rezerva Ligjore</i>	0
<i>Fitime te pashperndara</i>	(8,707,629)
<i>Fitime te vitit</i>	1,580,337
<b>Totali I Pasiveve</b>	<b>118,886,733</b>

### 3- Humbje te Pritshme nuk ka

Kapitali I Shoqerise Kontribuese prej **33.765.000 lek**, do te kaloje si capital shtese dhe do ti bashkohet Kapitalit te Shoqerise perthithese apo perfituese "Spar Albania"Sh.p.k.

### 4- MODALITETET:

- Shoqeria Perthithese "Spar Albania"Sh.p.k., do te jete perfituese e kontributeve te shoqerise "Spar Elbasani"Sh.p.k. ne daten e realizimit perfundimtar te bashkimit.
- Shoqeria Perthithese "Spar Albania"Sh.p.k.. gezon frutet e bashkimit duke filluar nga data 23.09.2018 me kusht realizimin ne fjale.
- Perkundrejt kontributit te perfituar Shoqeria "Spar Albania"Sh.p.k., si shoqeri Perfituese I njeh te drejten zoteruesit, ortakut te vetem te Shoqerise Kontribuese, Shoqerise "Spar Albania"Sh.p.k., kapitali I se ciles zoterohet nga ortaku I vetem personi juridik "Balfin" ku kapitali po I kesaj shoqerie zoterohet nga ortaku I vetem Z.Samir Mane te perfitojne nga ky kontribut(kapital) .
- Pjesa qe do te perfitojne zoteruesi I kapitalit te shoqerise perthithese "Spar Albania"Sh.p.k. nga kontribti I shoqerise te perthithur do te jete ne proporcion me perqindjen e zoterimit te kapitalit te shoqerise perthithese "Spar Albania"Sh.p.k., nga ortaku I vetem i saj 100%. Kjo menyre perfitimi te kontributit ne proporcion me perqindjet e zoterimit te kapitalit eshte duke ju referuar kushteve:
  - Ortaku I vetem I shoqerise perthithese "Spar Elbasani" eshte vete shoqeria "Spar Albania"Sh.p.k .,si shoqeri Perthithese.
  - Shoqeria perthithese "Spar Albania"Sh.p.k., merr persiper te gjitha te drejtat e detyrimet qe shoqeria e perthithur ka te evidentuara deri ne daten e projektit te marreveshjes, si dhe ato te drejta e detyrime qe mund te lindin ne te ardhmen per llogari te shoqerise qe perthithet.

- Raporti I kembimit eshte i njejte midis ortakut te vetem te shoqerise te perthithur me ortakun te shoqerise perthithese, pra ortaku I vetem perfiton aq sa zoteron tek kapitali I shoqerise perthithese, pa ndryshuar raporte.
- Perkundrejt kontributit te perfituar Shoqeria”Spar Albania”Sh.p.k., si shoqeri Perfituese do ti jape ortakut te vetem te shoqerise perthithese pjese nga kontributi I shoqerise te perthithur”Spar Elbasani” 100% te kapitalit, pasi ortaku I vetem I ortakut te shoqerise perthithese, qe eshte shoqeria “Balfin”sh.p.k. me ortakun e vetem Z.Samir Mane.
- Pjesa e kapitalit themeltar te nenshkruar e te regjistruar prej 33.765.000 lek e Shoqerise Kontribuese “Spar Elbasani”Sh.p.k. mbas bashkimit zyrtar te Shoqerive do te kaloje si pjese perberese e kapitalit te shoqerise ”Spar Albania”Sh.p.k. kundrejt kembimit te permendur me siper, ndaj ortakut te vetem te shoqerise qe perthithet “Spar Elbasani”Sh.p.k.

#### 5- DATA KONTABEL

Ne aspektin e regjistrimeve kontabel te gjitha operacionet e veprimtarise te shoqerise Kontribuese “Spar Elbasani”Sh.p.k. deri ne daten e miratimit dhe realizimit te bashkimit do te konsiderohen te kryera prej saj.

#### 6- RAPORTET E KEMBIMIT

- Bashkimi I te dy shoqerive nuk do te ndryshoje pjeset kontribuese ne perqindjet e zoteruesve te kapitalit te shoqerive, pasi ne te dy shoqerite qe marrin pjese ne kete operacion bashkimi”Perthithje”zoteruesi I kapitaleve te shoqerise te perthithur (kontribuese) eshte I njejti person, pra ortaku I vetem I shoqerise perthithese”Spar Albania”sh.p.k. eshte personi juridik “Balfin”sh.p.k., dhe kapitali I saj zoterohet nga ortaku I vetem Z.Samir Mane 100%.  
Duke ju referuar Neni 225” Bashkimi me perthithje në raste të veçanta” te Ligjit Nr.9901/2008 dhe kushteve te perberjes te ortakeve te shoqerive qe marrin pjese ne operacionin e bashkimit nuk eshte e nevojshme perdorimi I metodave te vleresimit per raportet e kembimit te kuotave midis shoqerive pjesemarrese ne operacionin e bashkimit, pasi kapitali zoterohet 100% nga I njejti person juridik, dhe ne perberjen e ortakeve te personit juridik eshte ortaku I vetem Z.Samir Mane.

Konkretisht ne kete nen eshte shprehur se:

*“1. Kur të paktën 90 për qind e kapitalit të regjistruar të një shoqërie aksionare kontrollohet nga mëma, bashkimi me përthithje ndërmjet këtyre shoqërive mund të kryhet pa miratimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë mëmë, me përjashtim të rasteve kur aksionarët ose ortakët e shoqërisë mëmë, që zotërojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të saj, të regjistruar, apo të numrit të përgjithshëm të votave, kërkojnë thirrjen e asamblesë së përgjithshme për miratimin e bashkimit.*

2. Kur mëma zotëron 100 për qind të aksioneve, shoqëria mëmë përthithëse nuk detyrohet të përmbushë kushtet e përcaktuara në nenet 216 pika 1 shkronjat "b", "c" e "ç", e 2 dhe 217 të këtij ligji. Gjithashtu, në këtë rast nuk zbatohen as dispozitat e nenit 224 të këtij ligji.
3. Dispozitat e neneve 206 deri në 212 të këtij ligji zbatohen edhe ndaj bashkimeve,

## 7- SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TE BASHKIMIT

Kapitali prej 33.765.000 lek I Shoqerise Kontribuese "Spar Elbasani"Sh.p.k.mbas bashkimit zyrtar do te pasqyrohet ne Pasivin e Bilancit, si shtese Kapitali per Shoqerine Perthithese "Spar Albania"Sh.p.k.,pa ndryshuar perqindjet te pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise perthithese si ortak I vetem me 100% te kapitalit te saj dhe kjo vlere do te jete si prim I bashkimit ne shoqerine perthithese.

**Kapitali I Shoqerise Perthithese "Spar Albania"Sh.p.k.,prej 600.502.914 lek pas bashkimit me shoqerine Kontribuese "Spar Albania "Sh.p.k. do te ndryshoje, duke u bere ne velre absolute prej 634.267.914 lek.**

## 8- TE DREJTA DHE AVANTAZHE TE TJERA

Ky operacion bashkimi nepermjet perthithjes nuk do te permbaje , te drejta dhe avantazhe te vecanta, për administratorët, anëtarët të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo audituesit ligjor/ekspertë kontabël të regjistruar.(Ref.nenit 225)

## 9- PASOJAT E BASHKIMIT

Bashkimi nuk do te kete asnje pasoje ndaj paleve te treat sic jane:

- Klientet, Debitorët, Kontratat, do te respektohen te gjithë te drejtat dhe detyrimet ne kontratat e lidhura midis shoqerise" Spar Elbasani"Sh.p.k. dhe klienteve te saj. Te gjitha te drejtat dhe detyrimet midis paleve kontraktuale do ti kalojne shoqerise Perthithese" Spar Albania"Sh.p.k.
- Te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Debitorëve te shoqerise se perthithur Shoqeria "Spar Elbasani"Sh.p.k. do ti respektoje Shoqeria perthithese "Spar Albania"Sh.p.k., ne vazhdimesi.
- Kreditorët, Furnitorët, Bankat, do te gezojne te gjithë te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjithë te drejtat e kreditorëve(Ortake, Furnitorët, Bankat) do te përmbushen nga shoqeria Perthithese" shoqerise perthithese "Spar Albania"Sh.p.k.

- Organet Tatimore, do te gezojne te gjithë te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjithë te drejtat e tyre do te permbushen nga Shoqeria Perthithese”Spar Albania”Sh.p.k.
- Punonjesit aktuale do te gezojne te gjithë te drejtat qe kane tek Shoqerite qe do te marrin pjese ne kete bashkim, pas ketij bashkimi te gjithë te drejtat e tyre do te permbushen nga Shoqeria Perthithese ”Spar Albania”Sh.p.k.
- Shoqeria e perthithur”Spar Elbasani”sh.p.k., me miratimin e marreveshjes te bashkimit dhe depozitimin ne QKB do te konsiderohet e c’regjistruar, pa likujdim.

10-Ligji I zbatueshem I Marreveshjes eshte ligji Shqiptar. Cdo mosmarreveshje apo konflikt ne lidhje me Marreveshjen do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykatat kompetente Shqiptare.

#### **11-TE DHENAT E SHOQERISE PERTHITHESE “AGNA”SH.A. PAS BASHKIMIT**

Pas perfundimit te bashkimit te dy shoqerive te shoqerise perthithese”Spar Albania”, me shoqerine e perthithur e perthithur “Spar Elbasani” te dhenat e shoqerise Perthithese”Spar Albania”Sh.p.k., do te jene:

- Selia; Farke LUNDER Qendra Tregtare Tirana East Gate, Rruga Nacionale Tirane-Elbasan, Farke, Lunder, Tirane, Shqiperi,
- Administratori: Znj. Elona Mema.
- Kapitali i shoqerise “Spar Albania”Sh.p.k., ”Shoqeria Perthithese” do te jete ne vlere absolute prej **634.267.914 (gjashteqintetridhjetekatermiljonedyqintegjashtedhjeteshtatemijenenteqintekatrembedhjetlek)**, I perbere nga 1(nje) kuote dhe do te zoterohet nga ortaku I vetem personi juridik ”Balfin”sh.p.k.
- Objekti I veprimtarise: Te gjitha dhe çdo aktivitet i shitjes me pakice, dhenies me qira dhe shitjes dhe blerjes te aktiviteteve te ndertimit te pasurive te paluajtshme; Drejtimi, administrimi dhe shfrytezimi i supermaketeve dhe hipermarketeve; Import – Eksport, shitja me shumice e pakice e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, prodhimi i produkteve ushqimore dhe joushqimore dhe transportimi dhe ruajtja e produkteve udhqimore dhe jo-ushqimore; Drejtimi i aktiviteteve te turizimit dhe te tjera; Import – eksport shitja me shumice e pakice e produkteve tekstile, veshjeve te te gjitha llojeve; Import-Eksport, shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyrash, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike, etj; Transport I mallrave dhe udhetareve Brenda dhe jashte vendit;

Ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e biznesit, manaxhimit, taksave, etj; Kembim valutor. Veprimtari e agjentit per trans ferte parash ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Veprimtari e agjentit komisioner. Hapjen e agjensive te udhetimit, turistike dhe reklamash. Hapjen e agjensive per shitjen e biletave ajrore, detare dhe tokesore. Transport mallrash dhe udhetaresh per vete dhe te trete brenda e jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Hapjen e dyqaneve per tregtimin e bizhuterive te te gjitha llojeve prej floriri, argjendi, sermi, diamanti, etj. Hapjen e qendrave dhe komplekseve sportive per argetimin dhe çlodhjen e njerezve, salla lojrash per femije dhe te rritur, salla per ushtrimin e forces per femije e te rritur. Hapjen e qendrave estetike, masazheve dhe kozmetike. Sherbim ne fushen e ushqimit social, bar-restorant, piceri, hoteleri, sherbime ne fushen e turizmit. Zhvillim te aktivitetit tregtar ne dyqane te te gjitha llojeve, lokale, markete dhe hipermarkete. Eksport-import sipas legjislacionit shqiptar. Kultmmi i produkteve bujqesore dhe frutikutures si dhe tregtimin me shumice e pakice i produkteve te tyre; Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

- 12- Shoqeria e perthithur ” Spar Elbasani” Sh.p.k ., vleresohet e prishur, e cila do te c’regjistrohet nga Qendra Kombetare e Biznesit
- 13- Ligji I zbatueshem I Marreveshjes eshte ligji Shqiptar. Cdo mosmarreveshje apo konflikt ne lidhje me Marreveshjen do te zgjidhet perfundimisht nga Gjykatat kompetente Shqiptare.
- 14- Marreveshja hyn ne fuqi ditën ne te cilen firmoset nga te dyja palet.
- Kjo Marreveshje eshte nenshkruar ne kater kopjo origjinale ne gjuhe shqipe.

**Per “ Spar Elbasani” sh.p.k.**

**Per “Spar Albania”sh.p.k.**

**ADMINISTRATORI**

**ADMINISTRATORI**

**Z.Elton SERJANI**

**Znj.Elona MEMA**

